

## FRANCEZJA AMANDA SYLA I RIKTHEHET ISLAMIT

Dita e 19 Korrikut 2010, në historinë e KBI-së do të shënohet si një ditë e veçantë, për faktin se radhëve të besimtarëve myslimanë, do t'i shtohet edhe një motër myslimane nga Franca. Amanda Syla, franceze, e lindur nga dy prindër të krishterë, por e martuar me një musliman shqiptar, me vullnetin dhe dëshirën e saj, paraqitet në zyrat e KBI-Vushtrri për zyrtarizim të rikthimit të saj në natyrshmëri, **në Islam**.

Duke qenë se koha ishte shumë afër namazit të drekës, shpejt e shpejt, Këshilli në përbërje të *Sedat Islamit*, sekretar, *Sadik Hasanit*, mual-lim, dhe Lumnije Zeqirit, ligjëruese për gjininë femërore, organizoi një ceremoni simbolike ne Xhaminë e Madhe “Shejh Zaid” në bashkëpunim edhe me Imamin Bedri ef. Halilin. Meqenëse ky i fundit i kishte lajmëruar xhematin pak çaste më parë, atmosfera në xhami ishte tejet mbresëlënëse. Amanda, e shoqëruar nga motra Lumnije Zeqiri, në prani të të gjithë besimtarëve, deklaroi se pa imponim bëhet myslimane. Xhamia ishte e vogël për të përballuar ato tekstile që jehonin brenda saj.

Le të shpresojmë se juve -të nderuar vëllezër dhe motra- do iu gëzojmë herë pas here me lajme të tilla si ky!

Me respektin më të madh,

KBI-Vushtrri

P.S. Ja edhe linku i ceremonisë.

<http://www.youtube.com/watch?v=3ZTOISggEVk>